



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 812/1 Prot.

Tiranë, më 23 . 06 . 2025

**V E N D I M**

Nr. 146, datë 23 . 06 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 125 Regj., datë 27.05.2025, të znj. D. Xh, kundër: z. S. R, Drejtor Ekzekutiv i “Laboratory Networks” shpk, znj. M. I, Drejtuese Teknike e Laboratorit të Anatomisë Patologjike, pranë “Laboratory Nertworks” shpk, dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), në të cilën pretendohet diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Referuar formularit të ankesës së depozituar pranë KMD-së<sup>3</sup>, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, ka parashtruar problematikën si më poshtë vijon:

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Si dhe parashtrime të dërguara nëpërmjet e-mailit të datës 27.08.2024, pranë KMD-së.

Prof. As. D. Xh është pedagoge në Departamentin e Anatomisë Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore”, në Fakultetin e Mjekësisë. Ka punuar si Shefe/Mjke Anatomopatologe, në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, për një periudhë afërsisht 11 vjeçare, nga viti 2012-2023.

Më datë 11 maj 2023, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes Partneritetit Publik Privat- PPP, Shërbimi i Anatomisë Patologjike për të gjithë spitalet u centralizuan në QSUNT, pranë Spitalit Onkologjik. Ankuesja pretendon se, sipas marrëveshjes verbale me M. I, do të mbulonte të gjitha biopsitë e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe do të ekzaminonte edhe materiale të tjera biptike apo citologjike, sipas nevoja të Shërbimit.

Me Urdhrin e Brendshëm me nr. 556, datë 25.11.2024, të Drejtorisë së QSUNT-së, “Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisiplinare/tumor borde”, është urdhëruar aktiviteti i këtyre bordeve, pjesë e të cilëve duhet të ishin edhe mjekët anatomopatologë.

Mes tjerash, ankuesja shprehet se: *“Mes emrave të përzgjedhur nga Drejtuesi Teknik, M. I, e cila mban edhe detyrën e Shefit të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, konstatova se një pjesë e tyre janë mjekë pa eksperiencë, pa tituj akademikë dhe pa aktivitet shkencor, madje ka edhe emra mjekësh të cilët marrin pjesë në më shumë se një bord, duke përjashtuar pjesën tjetër të stafit, duke mos qenë koherent dhe në përputhje me aftësitë profesionale të gjithsecilit prej nesh, edhe pse jam pedagoge dhe shërbimi që ofrojmë në kuadër të QSUNT-së është Universitar Terciar.*

*Ndërkohë që, në Laborator ka mjekë me tituj shkencorë, me aktivitet shkencor të admirueshëm, të cilat janë përjashtuar në mënyrë të qëllimshme, tendencioze nga znj. M. I, për shkak të qëndrimeve kritike ndaj veprimeve ose mosveprimeve të saj, ndonëse përfshirja në këto borde është pjesë përbërëse e detyrës dhe përgatitjes tonë profesionale.*

*Për sa më sipër, i jam drejtuar Drejtorisë së QSUNT-së, me shkresën me nr. 3077 prot., datë 26.12.2024, për të cilën nuk kam marrë asnjë përgjigje.*

*Në datën 17 mars 2025, në mënyrë të papritur, pa asnjë arsyetim të qartë, në kundërshtim me të drejtat e mia profesionale dhe ligjore, kam marrë njoftim për pezullim nga detyra, nga z. S. R, i cili është Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë Konkensionare “Laboratory Network” shpk.*

*Pezullimi nga puna është i lidhur me një biopsi me AR 00033348, të ekzaminuar nga ana ime në datë 25 shtator 2024, ku rasti është konsultuar me dy koleget e mia të nderuara E. K dhe B. C, të cilat kanë firmosur rastin në fjalë, në fletën origjinale të biopsisë.*

*Për shkak të vështirësisë diagnostike të rastit, kemi konkluduar në diagnozë diferenciale dhe kemi rekomanduar testet e biologjisë molekulare. Për rastin në fjalë, më është bërë presion në mënyrë të vazhdueshme nga drejtuesi teknik për të ndryshuar përgjigjen, por unë nuk kam pranuar. Për rastin në fjalë kam vënë në dijeni dhe drejtuesit e Konkensionarit (z. S. R dhe juristen L. M).*

*Në datë 11 tetor 2024, znj. L. M nëpërmjet e-mailit më ka vënë në dijeni se rasti do të dërgohet në një laborator referent, ku diagnoza rezultoi njëra nga dy diagnozat e sugjeruara nga ne si staf mjekësor. Kjo është një situatë e stisur në mënyrë të qëllimshme karshi meje....*

*Në shkresën e datës 17 mars 2025, pezullimi më ndalon dhe aksesin në Laborator, duke më penguar në punën time akademike dhe pedagogjike me studentët e Fakultetit të Mjekësisë dhe specialistët e Anatmisë Patologjike.*

*Në procesverbalin e dërguar nga ana e punëdhënësit në datë 21.05.2025, unë fajësohem për diagnozë të gabuar, duke cenuar reputacionin tim profesional dhe duke tejkaluar kompetencat profesionale dhe juridike, si të punëdhënësit dhe të avokatit të tyre, pasi nuk ka një akt ekspertimi mjeko-ligjor zyrtar.*

*Pezullimi nga detyra nuk parashikohet në kontratën e punës që kemi në fuqi, për më tepër në shkresën sipërcituar nuk ka asnjë referencë ligjore.*

*Të gjitha këto veprime më detyrojnë t'i drejtohem KMD-së, pasi M. I dhe S. R po synojnë të largojnë mjekë me eksperiencë, pedagogë të aftë të Shërbimit dhe të na zëvendësojnë me persona të tjerë që u binden verbërisht urdhrave të tyre.”*

*Ankuesja kërkon nga Komisioneri: “Verifikimin e rastit dhe të konstatojë shkelje të mundshme dhe të marrë masat e nevojshme për ndalimin e diskriminimit, për rivendosjen time në detyrë, si dhe sigurimin e kushteve të barabarta në ushtrimin e profesionit tim.”*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

*Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr. 125 Regj., datë 27.05.2025, rezultoi se ajo kishte nevojë të plotësonte disa prej kriterëve formalë të saj, sipas përcaktimeve të LMD-së. Për rrjedhojë, nëpërmjet e-mailit datë 28.05.2025, Komisioneri iu drejtua ankueses duke i kërkuar plotësimin e ankesës, veçanërisht në drejtim të provueshmërisë dhe lidhjes mes shkakut të pretenduar me sjelljen e veprimeve të secilit subjekt kundrejt të cilëve ka pretenduar diskriminimin kundrejt saj.*

Subjektit ankues, në vijim të komunikimit me inspektorin e çështjes, me datë 29.05.2025 është paraqitur pranë Zyrës së KMD-së, ku është sqaruar dhe informuar lidhur me kërkesat e LMD-së, në funksion të vijueshmërisë së shqyrtimit të ankesës. Ndër të tjera, ankuesja është informuar lidhur me përcaktimet e ligjit në kuadër të provueshmërisë dhe posedimit të shkakut të mbrojtur prej saj, si dhe lidhjes së tij me sjelljet, veprimet e mosveprimet e secilit prej subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën. Znj. Xh u shpreh se do të rikonsideronte ankesën e saj në tërësi dhe pasi të konsultohet me avokaten do të njoftonte KMD-në për vendimmarrjen e saj nëpërmjet e-mailit.

Në vijim, nëpërmjet e-mailit datë 04.06.2025<sup>4</sup>, subjekti ankues, znj. D. Xh, ka depozituar pranë KMD-së kërkesë për tërheqje nga ankesa e paraqitur pranë Zyrës së KMD-së.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar përcaktohet: “*3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohej e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Në nenin 94<sup>5</sup>/1 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me*

---

<sup>4</sup> Depozituar në cilësi prove në dosjen e ankueses, pranë KMD-së.

<sup>5</sup> “*Tërheqja e ankesës*”.

*kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës individuale, të paraqitur nga subjekti ankues, znj. D. Xh, e cila, me anë të kërkesës të përcjellë me e-mailin e datës 06.04.2025, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Për rrjedhojë, bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa pranë KMD-së, të paraqitur nga subjekti ankues në datën 04.06.2025, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 125 Regj., datë 27.05.2025, të paraqitur nga znj. D. Xh, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa, dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik<sup>6</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 125 Regj., datë 27.05.2025, të paraqitur nga znj. D. Xh, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>6</sup> Për analogji citojmë disa vendimmarje të Komisionerit, si: Vendimet me: nr. 83, datë 09.06.2023, nr. 195, datë 09.10.2023, nr. 228, datë 06.11.2023, nr. 230, datë 07.11.2023 dhe nr. 233, datë 07.08.2024, të KMD-së, nr. 240, datë 09.09.2024.